

LIGJ
Nr. 169/2020

PËR NJOHJEN SI PERIUDHË SIGURIMI PËR EFEKT PËRFITIMI
NGA SIGURIMET SHOQËRORE TË KOHËS SË PUNËSIMIT
NË ISH-KOOPERATIVAT BUJQËSORE

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ligji ka për qëllim njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore, për të cilat është djegur dokumentacioni arkivor i vjetërsisë në punë, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501 datë 19.7.1991, “Për token”, të ndryshuar.

Neni 2
Periudha e sigurimit dhe kushtet e njohjes së saj për efekt përfitimi

1. Njihet si periudha e sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, nga mosha për punë në kooperativat bujqësore e përcaktuar në legjislacionin e kohës, por jo më herët se viti i krijimit të kooperativës bujqësore, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për token”.

2. Njohja e periudhës së sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore sipas paragrafit të parë të këtij neni, në varësi të periudhës së deklaruar nga vetë personat kërkues, bëhet respektivisht me ditë, muaj ose vite të plota pune vetëm kur vërtetohet se gjatë periudhës së deklaruar:

- a) nuk ka qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie;
- b) nuk ka qenë përfitues i pensionit të invaliditetit të plotë;
- c) ka qenë banor i territorit në të cilin ka shtrirë aktivitetin e saj ish-kooperativa bujqësore.

Neni 4
Deklarimi i rremë

Deklarimi i rremë i kohës së punësimit pranë ish-kooperativave bujqësore nga personat kërkues përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Periudhat e sigurimit të njohura në ish-kooperativat bujqësore sipas nenit 2, kanë efekt për përfitime që nuk janë caktuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë listën e ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.12.2020.

**Shpallur me dekretin nr. 11903 , datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**